

VENDIM
Nr. 927, datë 19.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 315, DATË 23.3.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË
PROCESIT TË AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 2 dhe 3 të rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe mënyrën e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 315, datë 23.3.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen si më poshtë vijon:

“2. Tarifat për kryerjen e procesit të akreditimit nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, janë sipas aneksit A, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit dredhen 50% në buxhetin e Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe 50% në Buxhetin e Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI A
TARIFAT PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE
SHËNDETËSORE

1. Tarifat për realizimin e procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore që kryhen nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSA-ISH) janë si më poshtë:

1. Akreditim të spitaleve universitare	400.000 lekë;
2. Akreditim të spitaleve private	300.000 lekë;
3. Akreditim të spitaleve rajonale	300.000 lekë;
4. Akreditim të spitaleve bashkiake	200.000 lekë;
5. Akreditim të qendrave shëndetësore	60.000 lekë;
6. Akreditim të kabineteve mjekësore	50.000 lekë;
7. Qendër mjekësore	200.000 lekë;
8. Akreditim të laboratorëve mjekësorë	100.000 lekë;
9. Akreditim të klinikave stomatologjike	200.000 lekë;
10. Akreditim të kabineteve stomatologjike	50.000 lekë;
11. Akreditim të farmacive	50.000 lekë;
12. Akreditim të agjencive farmaceutike	10.000 lekë.